

Posta e Kosovës SH.A.  
Post of Kosovo J.S.C.  
Pošta Kosova D.O.O.  
Nr./No./Br 03-528/2021  
Data/Data/Datum 25-02-2021  
KRIJENI - EMBALUIM - EMBALUIM



Posta Kosovës SH.A.,  
Rr. "28 Nëntori" Nr. 4, Dardani  
10000 Prishtinë

## TERMET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### 1. Përmbajtja Neni 1

- (1) Termet dhe kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve universale postare (në tekstin e mëtejshëm: *Termet dhe Kushtet e Përgjithshme*) rregullojnë mënyrën, kushtet dhe procedurat e ofrimit të shërbimeve universale postare, të ofruara nga 'Posta e Kosovës', Shoqatë Aksionare, (në tekstin e mëtejshëm: *PK SHA*.) adresa: Rr. "28 Nëntori" Nr. 4, Dardani 10000 Prishtinë, afatet e dorëzimit të dërgesave, mënyrën dhe kushtet e pagesave për shërbimet postare, mënyrën për të treguar pagimin e taksës postare për shërbimet postare, procedurat e paraqitjes dhe zgjidhjes së ankesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve postare, përgjegjësit e palëve dhe kompensimi i dëmeve nga PK SHA, pasi të zërthehen ankesat dhe konstatohen përgjegjësit e ndaj konsumatorit.
- (2) Shërbim universal është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, me çmime të përballueshme, i mundshëm përherë, në të gjitha pikat e qasjes, për të gjithë shfrytëzuesit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendndodhja e tyre gjeografike.
- (3) Shërbimi universal në trafikun e brendshëm postar (në tekstin e mëtejshëm: trafikun e brendshëm) kryhet në mënyrë dhe në kushte të përshkruar me Ligjin Nr. 06/L-038, PËR SHËRBIMET POSTARE, (në tekstin e mëtejshëm: *Ligji*), aktet nënligjore të miratuar në bazë të Ligjit (në tekstin e mëtejshëm: *aktet nënligjore*), ligje të veçanta që rregullojnë mënyra tjera të dorëzimit të dërgesave postare, dhe me këto Terme dhe Kushte të Përgjithshme. Ndërsa në trafikun ndërkombëtar postar (në tekstin e mëtejshëm: *trafikun ndërkombëtar*) kryhet në përputhje me dispozitat e Konventës së Bashkimit (*Unionit*) Universal Postar (në tekstin e mëtejshëm: *UPU*), rregulloreve tjera ndërkombëtare dhe marrëveshjeve.
- (4) Shfrytëzuesi i shërbimeve postare është një person fizik ose juridik i cili shfrytëzon shërbimet postare, qoftë si dërgues apo marrës dërgesës postare.

#### 2. Shërbimi Universal Postar Neni 2

- (1) Shërbimi universal postar, sigurohet nga PK SHA, dhe kryhet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me kushte të njëjta, me një çmim unik dhe të përballueshëm dhe me cilësi të mirë për të gjithë shfrytëzuesit.
- (2) Shërbime universale postare janë shërbimet postare në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar, që përfshinë:
  - a) Pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare që peshojnë deri në dy (2) kg,
  - b) Pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove postare që peshojnë deri në dhjetë (10) kg,
  - c) Shërbimet e veçanta për dërgesat postare të regjistruara dhe dërgesat postare të siguruara,
  - d) Pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare, për personat e verbër (Sekogrameve), deri në shtatë (7) kilogram, pa pagesë.
- (3) Pavarësisht nga kufiri i peshës për pakot postare, i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, PK SHA, do të sigurojë që dërgesat postare të pranuar nga vendet e tjera dhe që peshojnë deri në njëzet (20) kg, të shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
- (4) Me rastin e dërgimit (postimit), dërguesi mund të kërkojë edhe shërbime plotësuese të përcaktuara me këto terma dhe kushte të përgjithshme.

### II. LLOJET E DËRGESAVE

#### 1. Dërgesa të korrespondencës Neni 3

- (1) Me dërgesë të korrespondencës nënkuptohet çdo komunikim i formës së shkruar, e shtypur apo edhe shkruar në letër, mall dhe sende të tjera të cilat duhet të dërgohen dhe shpërndahen dhe dorëzohen në adresën e përcaktuar nga dërguesi, të shënuar në vetë dërgesën apo në mbështjellësen/ambalazhin e saj të jashtme.
- (2) Me dërgesë të korrespondencës nënkuptohet edhe çdo letër dërgesë e thjeshtë, letër me prioritetet, kartëpostale dhe pako e vogël në komunikacionin vendor dhe ndërkombëtar.

#### 1.1 Letër dërgesa Neni 4

- (1) Letër dërgesa është dërgesë e mbyllur, e cila përmban komunikate të shkruar me ose pa vlerë të deklaruar, si dhe çfarëdo dërgesë tjetër e mbyllur që i plotëson kushtet e parapara për letër dërgesa, në aspektin e dimensionit dhe peshës, edhe nëse nuk përmban kurrfarë njoftimi me shkrim.
- (2) Letër dërgesa duhet jetë e mbyllur asisoj që përmbajtja e saj të jetë mire e mbrojtur nga dëmtimet eventuale me rastin e bartjes apo dëmtimit qëllimkeq pa ndonjë gjurmë të dukshëm.
- (3) Dimensionet për letër dërgesa janë si më poshtë:
  - a) Dimensionet minimale duhet të jen 90 x 140 mm, me një tolerancë 2 mm.
  - b) Dimensionet maksimale, gjatësia, gjerësia dhe trashësia së bashku 900 mm, ku asnjëra nga këto dimensionet nuk mund t'i kalojë 600 mm, me një tolerancë 2 mm.
  - c) Dimensionet minimale në formë ruloni ose cilindër, gjatësia plus dy herë diametrimin 170 mm, ku dimensionin më i madh të mos jetë më pak se 100 mm.
  - d) Dimensionet maksimale në formë ruloni ose cilindër, gjatësia plus dy herë diametri 1040 mm, me kusht që dimensionin më i madh të mos kalojë 900 mm.
  - e) Dimensionet e hapësirës së adresës së dërgesës 70 x 100 mm.
- (4) Peshë maksimale e letër dërgesës mund të jetë deri 2 kg.
- (5) Letër dërgesa duhet të ambalazhohen në mënyrë të duhur që të mos rrezikohet përmbajtja. Zarfi ose ambalazhi duhet ti përshtatet formës dhe natyrës së përmbajtjes së letër dërgesës dhe kushteve të transportit, mënjanimin e dëmtimit të punonjësve gjatë përpunimit
- (6) Adresa e marrësit duhet të vendoset në drejtim të gjerësisë së letër dërgesës, të shkruhet e saktë dhe e plotë, e lexueshme me shkronja latine ose alfabetit të vendit të destinimit dhe shifra arabe.
- (7) Për shënimin e adresës së marrësit, vendosjen e pullave dhe shenjave të tjera të frankimit duhet të rezervohet jo me pak se gjysma e djathtë e zarfit ose ambalazhit.
- (8) Pullat dhe shenjat e tjera të frankimit vendosen në anën e sipërme të djathtë të faqes së adresës.
- (9) Etiketat e shërbimit dhe shenjat e tjera të shërbimit vendosen nga ana sipërme majtas, ku është shënuar adresa e marrësit të letër dërgesës, në raste të veçanta ato mund të vendosen edhe nën adresën e marrësit.

#### 1.2 Letër dërgesa me prioritet Neni 5

- (1) Letër dërgesat postare me prioritet - transportohen me prioritet përmes rrugëve më të shpejta (ajrore apo tokësore). Letër dërgesat postare që trajtohen me prioritet ose me shërbime ajrore duhet të kenë të vendosur etiketë të veçantë me ngjyrë të kaltër me mbishkrimin 'PRIORITAIRE'; 'PAR AVION/ME AEROPLAN'.
- (3) Mbishkrimi 'PRIORITARE' apo 'PAR AVION/ME AEROPLAN', si dhe çdo shënim tjetër lidhur me transportin me prioritet apo me shërbim ajror, duhet të prishen me dy vija të trasha kryq, kur dërgimi i këtyre dërgesave postare nuk mund të bëhet me rrugë të shpejta.

#### 1.3 Kartëpostalja (panoramat) Neni 6

- (1) Kartëpostalja është letër dërgesë e thjeshtë e hapura që përmbajnë njoftime me shkrim, dhe është e punuar prej materiali të fortë të letrës në formë kënddrejtë.
- (2) Kartëpostalja e cila është emetim për komunikacionin e brendshëm postar duhet të ketë emërimin: 'Kartëpostale', dhe atë ndërkombëtar 'CARTE POSTALE'.

- (3) Kartëpostalja duhet të dërgohet e hapura, që do të thotë pa mbështjellëse apo zarfe. Së paku, gjysma e djathtë e pjesës së përparme rezervohet për adresën e të adresuarit, për frankim dhe për etiketat për shërbimet e veçanta.
- (4) Dimensionet e kartëpostales janë:
- a) Dimensionet minimale: 140 x 90 mm,
  - b) Dimensionet maksimale: 150 x 105 mm, me një tolerancë 2 mm.

#### 1.4 Pako e Vogël Neni 7

- (1) Pako e vogël është dërgesë postare që përmban sende të ndryshme në sasi të vogla, si prodhime artistike, kaseta, disqe, CD, shirita magnetik, mostra tregtie ose pjesë të një sendi që shërben si mostër tregtie, pjesë këmbimi për aparatura, duke përfshirë çdo mundësi për tu përdorur për qëllime biznesi.
- (2) Për pakot e vogla që dërgohen jashtë Republikës së Kosovës, që përmbajnë sende të ndryshme për doganim, është e domosdoshme t'i nënshtrohen kontrollit doganor. Mbi pako duhet të ngjitet pasi të plotësohet etiketa 'CN- 22', që është e barabartë me deklaratën doganore.
- (3) Për tu dalluar nga dërgesat tjera, për pakot në shërbimin e brendshëm të Kosovës duhet të vihet shënimi me shkronja të mëdha apo etiketa 'PAKO E VOGËL' dhe për jashtë Kosovës 'PETIT PAQUET'.

#### 1.5 Aerogrami Neni 8

- (1) Aerogrami është dërgesë e shtypur në një letër të hollë të qëndrueshme, e cila paloset në mënyrë të tillë që të formohet një drejtkëndësh me përmasat e një zarfi të zakonshëm.
- (2) Aerogrami i shpalosur ka një faqe të pastër në dispozicion të dërguesit për ta plotësuar sipas kërkesës së tij.
- (3) Pas palosjes në faqen e drejtkëndëshit që formohet, në pjesën e sipërme ka të shënuar me shkronja të mëdha 'AEROGRAM', si dhe shënimet përkatëse ku shkruhet adresa e marrësit, dërguesit dhe shënimet e tjera sipas kërkesave të shërbimit.
- (4) Aerogrami i palosur ka një anë të lyster me ngjitet (si kapaku i zarfit) i cili shërben për ta mbyllur aerogramin në mënyrë të tillë që të mos mund të hapet për të lexuar përmbajtjen. Marrësi për të lexuar përmbajtjen e aerogramit duhet ta pres në vendin e caktuar që është shënuar me një vijë që lehtëson shpalosjen e rregullt të aerogramit.
- (5) Aerogrami lëshohet në qarkullim nga Drejtoria e Postës të Kosovës, i shtypur me ose pa pulla të shtypura. Aerogrami trajtohet si dërgesa e postës së letrave në të cilën nuk lejohet të futen letra ose sende të tjera.
- (6) Dimensionet e aerogramit, janë si më poshtë:
- a) Dimensionet minimale: 90 x 140 mm,
  - b) Dimensionet maksimale: 110 x 220 mm, me një tolerancë 2 mm.

#### 1.6 Dërgesa e porositura (Rekomande) Neni 8

- (1) Si dërgese e porositur (Rekomande), nënkuptohet ajo dërgese për të cilën posta me rastin e pranimit obligohet të lëshoj vërtetimin mbi pranimin e dërgese, ndërsa me rastin e dorëzimit nga marrësi i dërgese kërkohet të vërtetoj pranimin e dërgesës. Pra, këto dërgesa duhet të kenë trajtim të veçantë përmes regjistrimit që nga pranimi deri te dorëzimi i dërgesës.
- (2) Etiketa 'RECOMMANDÉ- E POROSITUR', ose shkurtë 'R', duhet të vendoset nga ana e adresës së marrësi në anën e sipërme të majtë, dhe në raste të veçanta edhe nën adresën e dërguesit.
- (3) Për thasët special 'M' etiketa rekomande 'RECOMMANDÉ' (R) duhet të jetë e ngjitur mirë mbi etiketën adresës të shënuar nga dërguesi.
- (4) Në dërgesat postare me shërbim 'R' është e domosdoshme të shënohet adresa dërguesit dhe marrësit, saktë, e plotë dhe pa initiale. Asnjë kusht i veçantë nuk kërkohet për mbylljen e dërgesës postare të porositur.

- (5) Me marrjen e dërgesës postare të porositur nga dërguesi, punonjësi i zyrës postare është i detyruar t'i japë dërguesit një kopje të dëftesë të formular 'P 1', me të cilin vërtetohet pranimi i dërgesës postare nga punonjësi i zyrës postare.
- (6) Dërgesat postare të porositura duhet të kenë të vendosur dukshëm etiketën 'R' ose të shkruar qartë me germa shënimin 'REKOMANDE – E POROSITUR'.
- (7) Dëftesat e pranimi të dërgesave postare të shtypen në bllok me letër vetë kopjuese. Në rast se punëtori i postës bënë gabime gjatë plotësimit të dëftesës së pranimi ajo nuk shkëputet nga blloku, por bëhet vetëm shënimi 'Anullohet'.
- (8) Dërgesat postare të porositura të pranuar nga institucione dhe organizata të ndryshme, ose me kontratë, regjistrohen në librin e pranimi formulari 'P-2'.

#### 1.7 Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse

##### Neni 9

- (1) Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse është dërgesë e cila dërgohet nga institucionet gjyqësore, në zarfe me ngjyrë të kaltër ose të bardhë dhe si pjesë përbërëse ka fletë kthesën me të njëjtën ngjyrë e cila skajin e sipërm të zarfit e ka të përforuar (vrimosur).
- (2) Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse sa përket peshës dhe përmasave duhet t`u përgjigjet kushteve për letër dërgesë të thjeshtë. Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse është dërgesë e regjistruar për shkak të rëndësisë së tyre në proces.
- (3) Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse dorëzohet në përputhje me ligjet e veçanta që rregullojnë procedurat e dorëzimit. Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse në anën e adresës, përveç adresës së marrësit kanë shënimin e procedurës së veçantë të me shënim: "procedura civile", "procedura kundërvajtjes", "procedurë penale", "procedurë administrative", "procedurë e regjistrimit të kadastrit", "procedura përmbartimore", "procedura tatimore", ose ndonjë emërtim tjetër për identifikimin dhe trajtimin më të lehtë. Letër dërgesat që nuk përmbajnë të gjithë shënimet e përshkruar në faqen e adresës (*adresa e marrësit dhe shënimin e procedurës së veçantë*) mund t'i kthehen dërguesit për plotësim.
- (4) Dorëzimi i letër dërgesave gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse u bëhet personalisht marrësve. Në rast se marrësi nuk gjendet në adresën e tij, ajo mund ti dorëzohet njërit prej anëtarëve të familjes së tij për të cilën punonjësi i postës është i bindur se ai është pjesëtar i afërt i familjes së marrësit. Marrësi në dorëzim vërteton marrjen e komunikimit gjyqësor, kundërvajtës dhe administrativ duke nënshkruar në vendin e caktuar të fletëkthimit.
- (5) Në raste se punonjësi i postës, nuk gjen as marrësin as ndonjë anëtar të afërt të familjes, atëherë i lihet lajmërimi (raport) mbi arritjen përkatësisht koha e tentim dorëzimit të dytë të letër dërgesës gjyqësore, kundërvajtëse ose administrative.
- (6) Letër dërgesa gjyqësore dhe me procedurë kundërvajtëse me fletëkthim me ngjyrë të bardhë ose të kaltërt që përmban komunikime gjyqësore, kundërvajtëse ose administrative merret në dorëzim nga marrësi, ku marrësi në fletëkthim shënon datën, muajin dhe e vërteton me nënshkrimin e tij, ndërsa kur kjo pranohet në dorëzim nga njëri prej anëtarëve të familjes shpërndarësi i postës duhet të shënojë në fletëkthim marrëdhëniet e tij familjare me marrësin, si: "gruaja", "djali", "vajza", "vëllai" , "motra" etj.
- (7) Në raste se marrësi dhe ndonjë nga anëtarët e familjes nuk pranojnë të marrin në dorëzim letër dërgesën që përmban komunikim gjyqësor, kundërvajtës ose administrativ, shpërndarësi i postës bënë shënimin "Refuzohet të merret në dorëzim dhe shkurtimisht arsyet e refuzimit " dhe letër dërgesa që përmban komunikim gjyqësor ose administrative i kthehet dërguesit me postën e parë.
- (8) Nëse marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, punonjës i PK SHA, do të shënojë arsyen për këtë në fletëkthimi , emrin dhe mbiemrin i tij, datën e dorëzimit dhe arsyen pse marrësi nuk ka mundur ta nënshkruaj.
- (9) Nëse marrësi refuzon të nënshkruajë në fletëkthimin ose të plotësojë datën e dorëzimit, atëherë punonjës i PK SHA, do ta shënojë datën e dorëzimit në fletëkthimi dhe ta nënshkruajë atë, ndërsa shkresën (letrën) ia dorëzon marrësit.
- (10) Të dhënat e tjera për shënimet e dorëzimit në fletëkthim përcaktohen në përputhje me dispozitat e ligjeve të veçanta që rregullon secilën procedurë individuale.

## 1.8 Letra administrative Neni 10

- (1) Letra administrative janë dërgesa të regjistruar me shërbim të veçantë 'E POROSITUR/REKOMANDE' ose 'R' me të cilët punëdhënësit u japin vendime punonjësve, në zarfe të veçanta dhe në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon marrëdhënien e punës.
- (2) Letra administrative nga ana e adresës, përveç adresës së marrësit, kanë shenjën: "letër administrative", e cila tregon një mënyrë të veçantë të trajtimit të letrës. Gjatë dorëzimit të letrave/dërgesave administrative, veprohet në përputhje me ligjin që rregullon dorëzimin e letrave/dërgesave në procedurat civile.

## 1.9 Dërgesa postare me vlerë të deklaruar Neni 11

- (1) Dërgesa postare me vlerë të deklaruar (*Letër dërgesë me vlerë*) pranohen me kërkesën e dërguesit duke deklaruar vlerën e përmbajtjes si tij. Për shërbimin e brendshëm deklarimi i vlerës bëhet në Euro, ndërsa për shërbimin ndërkombëtar deklarimi i vlerës bëhet në DTS (*DROITS DE TIRAGE SPECIAUX- E DREJTA E TËRHEQJES SPECIALE*). Konvertimi i vlerës në DTS, bëhet nga punonjësit e postës sipas kursit të këmbimit ditorë. Vlera e deklaruar shënohet nga dërguesi mbi adresën e marrësit me shkrim dhe me shifra.
- (2) Punonjësi i pranimit të postës që regjistron dërgesat postare me vlerë të deklaruar në dëftesën e pranimit formulari 'CP-4', në dy kopje që përmban:
  - a) Numrin serik të dëftesës;
  - b) Numrin e dërgesës postare;
  - c) Emri dhe mbiemri i marrësit;
  - d) Emri dhe mbiemri i dërguesit dhe vend arritja;
  - e) Vlerën e deklaruar të dërgesës postare;
  - f) Datën e pranimit;
  - g) Peshën në kg /gr;
  - h) Tarifën e paguar nga marrësi;
  - i) Vulën datare të zyrës të postës së pranimit;
  - j) Vulën personale të dërguesit
  - k) Emri dhe mbiemri dhe nënshkrimi i pranuesit të zyrës së postës;
  - l) Shërbime të veçanta nëse kërkohen nga dërguesi.
- (1) Zarfi apo ambalazhi i dërgesës postare me vlerë të deklaruar duhet të jetë i përshtatshëm, që të sigurojë përmbajtjen, nga dëmtimet e mundshme gjatë transportit dhe përpunimit. Është e ndaluar të përdorin zarfe ose ambalazhe krejtësisht të tejdukshme ose me dritare. Punëtori i postës duhet t'ua rekomandojë dërguesve që ambalazhimi i dërgesave postare me vlerë të deklaruar të bëhet me një ambalazh të brendshme më të fortë se letra.
- (2) Vula e dërguesit me ngjyre tamponi (*e thatë*) vendoset në anën e pasme të dërgesës dhe në dëftesën e pranimit formulari 'CP-4'. Letra me vlerë duhet të sigurohet edhe me etiketat siguroese postare vetë ngjitëse. Në shërbimin e brendshëm me udhëzime të veçanta të Postës të Kosovës SH.A. mund të përdoren edhe shenja e mjete të tjera sigurie.
- (3) Dërgesat postare me vlerë të deklaruar pajisen me një etiketë shërbimi ku shkruhet dukshëm 'VLERË E DEKLARUAR' për brenda vendit dhe 'VALEUR DECLAREE', për jashtë Republikës së Kosovës ose një etikete me shkronjën 'V' që përmban emrin e zyrës pranuese dhe numrin e dërgesës postar me vlerë të deklaruar. Kjo etikete 'V' dhe pesha e saktë në gram vendosen në anën e sipërme majtas të faqes së adresës së marrësit.
- (4) Adresa e saktë dhe pa korrigjime e marrësit dhe e dërguesit të dërgesës postare me vlerë të deklaruar janë kusht i domosdoshëm.
- (5) Vlera maksimale e një dërgesës/ letre me vlerë nuk mund të jetë më madhe se njëmijë euro (1,000€), në trafikun e postës vendore dhe jo më shumë se katërmijë DTS (4.000 DTS), në trafikun e postës ndërkombëtare.
- (6) Shuma e vlerës së deklaruar për letër dërgesa e dokumente që përfaqësojnë një vlerë për shkak të ribërjes së tyre nuk mund të tejkalojë shpenzimet eventuale të këtyre dokumenteve në raste humbjeje.
- (7) Tarifimi i këtyre dërgesave postare mund të bëhet me pulla postare ose me shënimin 'TAKSE E PAGUAR', për brenda Kosovës, ose 'TAXE A PERCUE', për jashtë Republikës së Kosovës. Letër dërgesa me vlerë për jashtë Republikës së Kosovës procedohet në mënyrë të veçantë dhe parapakisht në njoftim vendeve të destinacionit dhe (UPU).

- (8) Përmbajtja e letër dërgesës me vlerë duhet ti përgjigjet vlerës reale të përmbajtjes së deklaruar. Në rast se dërguesi i dërgesës postare me vlerë të deklaruar ka mashtruar në deklarimin e vlerës, ai i nënshtrohet gjykimin sipas dispozitave ligjore të parashikuar në kodin penal të Republikës së Kosovës.

## 2. Pakot (Kolit) Neni 12

- (1) Pakot (kolit), janë dërgesa postare që përmbajnë mallra apo gjësende të ndryshme dhe për të cilën dërguesit i lëshohet vërtetim mbi pranim e saj, dhe njëkohësisht i dorëzohet marrësit me konfirmim të nënshkrimit të dorëzimit në dokumentet përkatëse. Në pako mund të vendoset korrespondenca midis dërguesit dhe marrësit dhe personave që jetojnë me ta, materiale arkivore, ndërsa korrespondencat të tjera janë të ndaluara. Në përmbajtje të pakos nuk lejohet të dërgohen dërgesa postare nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postar.
- (2) Pako, mund të pranohen me peshë deri në dhjetë (10) kg, ndërsa në trafikun ndërkombëtar në ardhje mund të pranohen me peshë deri njëzet (20) kg.
- (3) Në trafikun e brendshëm pakoja duhet të ketë vlerën të shënuar, dhe në trafikun ndërkombëtar pakoja mund të jetë me vlerë të shënuar ose pa vlerë të shënuar.
- (4) Vlera e përmbajtjes së paketës tregohet me numra dhe shkronja në pjesën e poshtme të majtë të faqes së adresës.
- (5) Vlera maksimale e shënuar e një pakete në trafikun e brendshëm mund të jetë një mijë (1.000) Euro.
- (6) Pesha e pakos duhet të shënohet në paketim në gram.
- (7) Dimensionet e paketimit nuk mund të kalojnë 3.000 mm, në shumën e gjatësisë dhe perimetrit të pakos në pjesën më të gjerë në mënyrë diagonale, me kusht që asnjë nga dimensionet nuk mund të jetë më i madh se 1.500 mm. Pako nuk duhet të jetë më e vogël se dimensionet minimale të parapara për letër, sipas nenit 4, të këtyre kushteve dhe Termeve të Përgjithshme, me kusht që ana e adresës të ketë një hapësirë me dimensione minimal prej 90 mm x 140 mm.
- (8) Në trafikun ndërkombëtar, pakoja/kolia mund të transportohet si 'Ekonomike' dhe si 'Premium'. Një pako/koli ekonomike është ajo për të cilën dërguesi nuk ka kërkuar një proces më të shpejtë të rrugëtimit dhe transmetimit, dhe një pako/koli 'Premium', siguron një proces më të shpejtë të kursimit dhe transmetimit në krahasim me paketat e tjera. Paketat Premium janë të etiketuar 'PRIORITAIRE/PAR AVION', ose 'ME PRIORITET/ ME AEROPLAN'.

## 3. Dërgesa për të verbër/Sekogrami Neni 13

- (1) Dërgesa për të verbër / Sekogrami është dërgesa e shtypura me relief që përdoren nga personat e verbër. Ato duhet të ambalazhohen në mënyrë të tillë që të mbrohet mirë përmbajtja e tyre, por edhe të mos pengohet një verifikim i lehtë dhe i shpejtë i përmbajtjes së tyre.
- (2) Mund të pranohen si sekograme, letrat sekografike dhe klishetë që përmbajnë shenja të sekografisë. Gjithashtu mund të pranohen si sekograme edhe regjistrimet e zërit si dhe letra speciale e caktuar për tu përdorur nga të verbërit, me kushte që ato të jenë të dërguara nga një institut për të verbrit i njohur zyrtarisht, ose që i drejtohen një instituti të tillë.
- (3) Në shërbimin postar ndërkombëtar, lejohet të trajtohen si sekograme të gjithë dërgesat që trajtohen si të tilla edhe në shërbimin e brendshëm, dhe rekomandohet që në çdo rast ato të pajisen me një etiketë të bardhë me simbolin e caktuar për këtë qëllim 'Sekogram', në trafikun vendor dhe 'Cecogramme'.
- (4) Sekogramet mund të pranohen me peshë deri në 7 kg dhe janë të përjashtuar (lirohen) nga tarifat e shërbimit, përveç nëse nga dërguesi kërkohet ndonjë shërbim i veçantë.

## III. SHËRBIMET PLOTËSUESE

### 1. Shërbimet plotësuese Neni 14

- (1) Shërbimet plotësuese janë shërbime që nënkuptojnë mënyrë të veçantë të trajtimit të dërgesave gjatë procesit të pranimit, përpunimit, transportit dhe dorëzimit, dhe gjatë procesit të kryerjes së shërbimit universal për të cilat paguhen tarifa e caktuar sipas Listës së Çmimeve në fuqi.
- (2) Me shërbimet plotësuese, në kuptim të paragrafit 1, të këtij neni, do të konsiderohen shërbimet si në vijim:
  - a) Shërbimi "Lajmërim Marrje",
  - b) Shërbimi "Kundërpagesë",
  - c) Shërbimi "T'i dorëzohet personalisht marrësit",
  - d) Shërbimi "Grupimi i dërgesave - Consignment",
  - e) Shërbimi "E veçantë",
  - f) Shërbimi "Kaba",

- (1) Shfrytëzimi i shërbimeve plotësuese në trafikun ndërkombëtar varet nga kushtet për pranimin e dërgesave të secilit vend individual, informatat për kushtet e pranimit janë dispozicion në [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com) ose në zyrat postare.

#### 1.1. Lajmërim marrje

##### Neni 15

- (1) Me shërbim plotësues '*Lajmërim marrje*', dërguesi me rastin e dorëzimit të dërgesës kërkon që dërgesa t'i dorëzohet marrësit me konfirmim të shkruar. Formulari i plotësuar (*Fletëkthimi - P3 dhe CN 07*) pranohet nga dërguesi së bashku me dërgesën, gjithashtu mund të jetë pjesë përbërëse e zarfit të dërgesës.
- (2) Dërgesat postare të pranuar, për të cilat dërguesi kërkon konfirmimi të dorëzimit të dërgesës, duhet të kenë në anën e adresës së marrësit me shkrim shumë të dukshëm, ose etiketën : '*LAJMËRIM MARRJE*', ose '*LM*', për brenda vendit dhe shënimin '*AVIS DE RECEPTION*' ose '*AR*', për trafikun ndërkombëtar.
- (3) Dërgesat postare të pranuar me lajmërim marrje për trafikun ndërkombëtar, shoqërohen me një formularë '*CN- 07*', që ka fortësinë e një kartëpostale me ngjyrë të kuqe të çelur, ndërsa për dërgesat postare të pranuar për trafikun vendor, shoqërohen me një formular '*P-3*'.
- (4) Ana e përparme e formularit duhet të plotësohet nga zyra e origjinës ose nga çdo zyre tjetër e caktuar nga administrata dërguese, dhe duhet të bashkëngjitet në mënyrë të sigurt dërgesës. Në qofte se formulari nuk mbërrin në zyrën e destinacionit, kjo zyre duhet të hartojë menjëherë një formular të ri ( *Fletëkthimi - P3 apo CN07* ) .
- (5) Zyra e destinacionit menjëherë pas dorëzimit të dërgesës, formularin '*Fletëkthimi - P3 ose CN 07*', të plotësuar drejtë nga marrësi si konfirmim për dorëzim dhe të vulosur nga po nga kjo zyrë e kthehen menjëherë zyrës së origjinës ku më pastaj ajo në këmbimet e para të rregullta ditore e kthen të dërguesi.
- (6) Shërbim plotësues me '*Lajmërimi marrje*', mund të pranohen dërgesat me shërbim të porositur '*R*' (Rekomande), dërgesat me vlerë të deklaruar dhe pakot.

#### 1.2. Kundërpagesa

##### Neni 16

- (1) Dërgesa me kundërpagesë është dërgesë e cila i dorëzohet marrësit pasi të ketë arkëtuar paraprakisht shumën e kundërpagesës në dobi të dërguesit. Vlera e deklaruar në dërgesat postare me kundërpagesë nuk mund të jetë më e vogël se 10 Euro, dhe më e madhe se 1.000 Euro, në rast se do të arkëtohet kundërpagesa me urdhërpagesë formulari '*P-15*', dhe 1.000 Euro, në rast se kundërpagesa do të arkëtohet me fletëpagesë bankare, përkatësisht me urdhërpagesë, në dobi të llogarisë rrjedhëse apo xhirollogarisë të dërguesit. Vlera e deklaruar duhet me domosdo ti përgjigjet vlerës reale të dërgesës pasojat e mos deklarimit të vlerës reale janë përgjegjësi e dërguesit.
- (2) Punëtori i zyrës së postës për çdo dërgesë postare me kundërpagesë të pranuar plotëson në dy kopje dëftesën e pranimit formulari '*CP-1*', ose e regjistron në librin e pranimit formulari '*P-2*', kur është parashikuar pranimi me kontratë.
- (3) Dërguesi së bashku me dorëzimin e dërgesës postare me kundërpagesë, është i detyruar të dorëzojë edhe urdhërpagesën postare ose fletëpagesën bankare të plotësuar, në bazë të së cilës do të paguhet kundërpagesa. Këto dokumente duhet të ngjiten fortë mbi dërgesë postare në mënyrë që të mos shpëputen nga dërgese postare gjatë transportit dhe përpunimit. Kur dërguesi kërkon që kundërpagesa ti kalohet në llogarinë e tij bankare të plotësuar, ai është i detyruar të deklarojë xhirollogarinë dhe bankën përkatëse.

- (4) Tarifat e pranimit të dërgesës postare me kundërpagesë arkëtohen nga marrësit e dërgesave. Në raste se dërgesa postare me kundërpagesë i kthehet dërguesit për arsye të pamundësive për t'ia dorëzuar marrësit, tarifat e kthimit janë në llogari të dërguesit.

### 1.3. T'i dorëzohet personalisht marrësit

#### Neni 17

- (1) Dërgesat postare që kërkohen nga dërguesi për t'iu dorëzuar personalisht në dorë vetëm marrësit, ose personit ligjor të autorizuar nga ai, dërgesa e tillë mund të jenë dërgesat postare të porositura, me vlerë të deklaruar ose me kundërpagesë.
- (2) Mbi këto dërgesa postare, në faqen e adresës të marrësit duhet të ketë të shënuar me shkronja të dukshme shënimin; '*TI DORËZOHET PERSONALISHT MARRËSIT*', për brenda vendit, dhe shënimin; '*A REMETRE A MAIN PROPRE*', për dërgesat postare për trafikun ndërkombëtar.

### 1.4. Grupim i dërgesave - Consignment

#### Neni 18

- (1) Shërbimi plotësues '*Consignment – Grupim i dërgesave me shumicë*', në trafikun ndërkombëtar ofron mundësinë e dërgimit të dërgesave postare me shumicë nga i njëjti dërgues tek një ose më shumë marrës.
- (2) Kushtet dhe kushtet për ofrimin e shërbimit të dërgesave '*Consignment – grupim i dërgesave*' rregullohen me marrëveshjen të veçantë në mes të Administratave Postare, pra PK SHA. dhe ofruesit e shërbimeve postare të vendit të destinacionit në përputhje me aktet e UPU-së.

### 1.5. Dërgesë e veçuar

#### Neni 19

- (1) Shërbimi plotësues dërgesë '*E veçuar*', është shërbim i tillë ku dërguesi kërkon mënyrë të veçantë të bartja dhe dorëzimi i këtyre dërgesave. Si dërgesë e veçuar mund të dorëzohet çdo pako, pavarësisht nga lloji dhe natyra e përmbajtjes së saj.
- (2) Si pako gjithmonë të veçanta duhet të dorëzohen pakot të cilat përmbajnë: kafshë të gjalla, sende që thyhen lehtë, lëngje, lëndë që shkrihen lehtë, pjesë të trupit të kafshëve ose të trupit të njeriut, si dhe mekanizma të tjerë të ndjeshëm etj.
- (3) Në pakon e veçuar dërguesi ka për detyrë që të shënoj shenjën përkatëse ose të vejë etiketën përkatëse, e cila paralajmëron natyrën përmbajtjes së pakos si psh; "E thyeshme", "Kafshë të gjalla", "Kujdes nga nxehësia", "Mos e rrotullo", "Xham", etj.

### 1.6. Pako/Koli Kaba

#### Neni 20

- (1) Me shërbim plotësues 'Kaba', pranohet çdo koli e cila i kalon dimensionet e parapara për pranim të kolive, si dhe ka formë të rregullte në aspektin e jashtëm. Nëse një koli e pranuar me shërbime plotësuese është '*E veçuar*', dhe 'Kaba', tarifa postare plotësuese paguhet vetëm për njërin bazë.

## 2. Shërbimet tjera plotësuese

### 2.1. Shërbimet tjera plotësuese të cilat mund t'i kërkoj dërguesi

#### Neni 21

- (1) Shërbimet tjera plotësuese janë shërbime postare përmes të cilave dërguesi, pas dorëzimit të dërgesës, përkatësisht se të dorëzohet dërgesa, kërkon mënyrën e caktuar të dorëzimit dhe vendin e dorëzimit të dërgesës, me këto shërbime plotësuese:
- që në dërgesë të ndryshohet ose plotësohet adresa;
  - që dërgesa të kthehet,



- c) që dërgesat e regjistruar të ngarkohet me "kundërpagesë", që shuma me kundërpagesë të ngritët ose të ulet, apo edhe të hiqet dorë nga kundërpagesa,
  - d) që të bëhet dërgimi i pakos për marrësin ose të mos bëhet fare.
- (2) Kërkesën për shërbime tjera plotësuese, sipas pikës 1, çdo dërgues i një dërgese postare ka të drejtë të kërkojë nga shërbimi postar që dërgesa postare e dorëzuar prej tij më përpara t'i kthehet atij ose të kërkojë ndryshim apo korrigjim adrese. Kur dërgesa postare në kohën e bërjes së kërkesës për tërheqjen e dërgesës që nuk është dërguar për në zyrën e destinacionit dhe ndodhet në zyrën e postës së pranimit, dërgesa postare i dorëzohet dërguesit, pasi të regjistrohet në librin e dorëzimit ku vihet shënimi "dorëzuar marrësit me datën\_\_\_\_" dhe firmoset prej tij. Ky shënim bëhet edhe në formularin 'P-1' ose 'CP-4' që i merret dërguesit.
  - (3) Kur kërkesa bëhet për tërheqje, korrigjim ose ndryshim adrese të marrësit të një dërgese postare të porositur, me vlerë të deklaruar, me kundërpagesë, dërguesi duhet të paraqesë dëftesën e pranimit Formular 'P-1', ndërsa për letrat me vlerë të deklaruar dëftesën e pranimit formulari 'CP-4', dhe të vërtetoj identitetin e tij.
  - (4) Kur dërgesa postare në kohën e bërjes së kërkesës për tërheqjen e dërgesës ende nuk është dërguar për në zyrën e destinacionit dhe ndodhet në zyrën e postës së pranimit, dërgesa postare i dorëzohet dërguesit, pasi të regjistrohet në librin e dorëzimit ku vihet shënimi "dorëzuar marrësit me datën\_\_\_\_", dhe nënshkruhet prej tij. Ky shënim bëhet edhe në formularin 'P-1' ose 'CP-4' që i merret dërguesit.
  - (5) Kur dërgesa postare në kohën e bërjes së kërkesës për tërheqje, ndryshim apo korrigjim adrese është dërguar për në zyrën postare të destinacionit, dërguesi duhet plotësoj kërkesën përkatëse sipas formularit 'CN -17', kur dërgesa postare është për jashtë Kosovës, dhe formularin 'P-4', për brenda Kosovës. Këta formular i dërgohen menjëherë zyrës së destinacionit si dërgesë postare e porositur dhe tarifa e shërbimit paguhet nga dërguesi përveç pagesës së bërë për tërheqje ndryshim apo korrigjim adrese. Kur dërguesi dëshiron që kërkesa e tij të vijohet me rrugë ajrore për dërgesa postare për jashtë Kosovës, ai duhet të paguaj edhe tarifatat shtesë të postës ajrore.
  - (6) Zyra e destinacionit me të marrë kërkesën vepron menjëherë për plotësimin e saj. Kur kërkesa zbatohet formulari 'P-4', ose 'CN-17', ruhet në zyrën e destinacionit me shënimet e duhura. Në rast se kërkesa nuk ka mundësi të zbatohet, për arsye se dërgesa postare i është dorëzuar marrësit, atëherë formulari 'P-4', ose 'CN-17', me arsyet e mosveprimit i kthehet zyrës së origjinës për ta komunikuar dërguesin.
  - (7) Me rastin e paraqitjes së kërkesës, dërguesi është i detyruar të tregoj identitetin e tij dhe të paraqesë dëshminë e dërgesës së pranuar përmes dëftesë së lëshuar për pranim (*formulari P1*).

## 2.1. Shërbimet tjera plotësuese të cilat mund t'i kërkoj marrësi

### Neni 22

- (1) Marrësi para dorëzimit të dërgesës mund të kërkoj këto shërbime plotësuese:
  - a) Që dërgesa të mbahet në zyrë postare, në zyrën e përpunimit, apo ridërgim në një adresë tjetër për të cilën përcaktohet,
  - b) Që dërgesa t'i dorëzohet personalisht marrësit,
  - c) Që dërgesa e arritur përpos letrës gjyqësore dhe letrës me procedurë administrative dhe kundërvajtëse, t'i dërgohet lajmërimi mbi arritjen e dërgesës së tillë dhe mbahet në Fahë Postar,
  - d) Që çdo dërgesë ose dërgesa e caktuara të dorëzohet si urgjente në zonën e ngushtë të zyrës postare,
  - e) Që dërgesa e arritur, me përjashtim të letrës gjyqësore, kundërvajtëse dhe me procedurë administrative, të ruhet si dërgesë 'Post-restant', ose të dërgohet në vendarritje të re, dhe në këtë vendarritje të re, t'i dorëzohet në banesë ose në lokalit e punës të personit, të cilin është përcaktuar vetë.
  - f) Vendosjen dërgesës së regjistruar në kuti shtëpiake paraprakisht për këtë të bëhet autorizimin me shkrim nga ana e marrësit në PK SHA. Ky shërbim kryhet vetëm për dërgesat në trafikun e brendshëm, me kusht që nuk mund të kërkojë për dërgesat e regjistruara me shërbime plotësuese; 'Kundërpagesa', 'Fletëkthim' dhe 'T'i dorëzohet personalisht marrësit',
  - g) Ridërgimi i dërgesës për të cilën është lënë njoftimi për mbërritjen e dërgesës.
- (1) Marrësi mund të kërkojë shërbimet nga paragrafi 1, i këtij neni duke paraqitur një kërkesë me shkrim, përveç pikës 7, të cilën ai e kërkon me telefon, si rregull, në zyrën postare që dorëzon sendet.
- (2) Me rastin e paraqitjes së një kërkesë me shkrim, marrësi dëshmon identitetin e tij dhe tregon informacionin e nevojshëm për të vepruar sipas kërkesës.

- (3) Afati deri në të cilin kërkesa mund të përpunohet nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë ose më i gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë në rastin ridërgimit. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1, pika c, e këtij neni anulohet, dhe kërkesa e përmendur në paragrafin 1, pika d, e këtij neni do të paraqitet një herë për çdo dërgesë dhe do të jetë e vlefshme brenda pesë (5) ditëve të punës, derisa dërgesa të ruhet në zyrën postare .
- (4) Kërkesa e marrësit nuk do të merret nëse kërkesa e dërguesit brenda kuptimit të nenit 22, të këtyre termave dhe kushteve të përgjithshme ka mbërritur në zyrën postare përpara dorëzimit të dërgesës me të cilën ka të bëjë kërkesa.
- (5) Kur një dërgues deklaron se i ka humbur dëftesa e pranimit të dërgesës postare që ka dorëzuar në zyrën e postës, kërkon një dublikatë, ajo mund të jepet pas verifikimit të identitetit të tij dhe verifikimit në librin e pranimit nëse ajo dërgesë postare është pranuar dhe regjistruar në librin e pranimit formulari "P-1".
- (6) Për çdo dëftesë të lëshuar vendoset shënimi 'DUBLIKATË' dhe paguhet sipas tarifave postare në fuqi.
- (7) Kur marrësi importoni mallra nga trafiku ndërkombëtar, mund të kërkojë shërbime përcjellëse të siguruara nga PK SHA.
- (8) Me rastin e importit të mallrave nga trafiku ndërkombëtar, marrësi mund të kërkojë shërbimin e paraqitjes së shpejtë të dërgesave për kontrolle doganor/nënshtrim të procedurave të shpejta doganore.
- (9) Për shërbimet e përmendura në këtë nen, paguhen tarifat e miratuara të parapara për këto shërbime.

#### 4. Fahu postar Neni 23

- (1) Shfrytëzuesit e shërbimeve postare qofshin ata persona fizik apo juridik mund të kërkojnë që dërgesat e postës së letrave të thjeshta dhe lajmërimet për arritjen e dërgesave të tjera të regjistruara që arrijnë në adresë të tyre të vendosen në një kuti - fahë postare, duke parapaguar sipas tarifave të caktuara në tarifat postare.
- (2) Marrësi mund të pranoj letër dërgesat postare përmes fahut postar, me përjashtim të dërgesave *Express*. Kontrata lidhet në zyrën postare ku marrësi dëshiron të hap një fahë postar.
- (3) Për dërgesat për të cilat kërkohet konfirmimi i nënshkrimit të marrësit, në ndarje/sortim i lihet njoftimi për mbërritjen e dërgesës ose njoftimi tjetër i duhur. Nëse marrësi nuk tërheqë dërgesat brenda afateve të parapara për tërheqje (pesë (5) ditë rajoni ngushtë, tetë (8) ditë rajoni i gjërë dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë rajoni më i gjërë) nga dita e lënies së njoftimit, dërgesat i kthehen dërguesit.

### IV., PRANIMI I DËRGESAVE POSTARE

#### 1. Dispozitat e përgjithshme për pranimin e dërgesave postare Neni 24

- (1) Pranimi i dërgesave postare është procedurë e marrjes së dërgesave postare për dorëzim në adresë të marrësve. Dërgesat mund të pranohen nga personat fizik dhe juridik në zyrën postare /sportel, përmes kutive postare ose në adresën e dërguesit ose vendndodhjen tjetër të kontraktuar, përmes punëtorëve PK SHA, në përputhje me marrëveshjet e arritura.
- (2) Dërgesat e regjistruara janë dërgesa postare ku posta me rastin e pranimit dërguesit i lëshon vërtetimin mbi pranimin e dërgesës, ndërsa me rastin e dorëzimit nga marrësi kërkohet të konfirmoj pranimin e sajë.
- (3) Pranimi i disa dërgesave postarë kryhet nën kushtet e përcaktuara me ligje dhe rregullore të tjera të miratuara në bazë të atyre ligjeve.
- (4) Në përputhje me dispozitat e paragrafit 3, të këtij neni, rregulloret e mëposhtme do të zbatohen për marrjen e dërgesave.

- (5) Për dërgesat e brendshme që përmbajnë sende, për të cilat kërkohet miratim ose konfirmimin nga organet shtetëror të autorizuar, siç janë institucionet apo organizatat e autorizuar, dërguesi është i detyruar të paraqesë autorizimin (vërtetimin) e tillë së bashku me dërgesën,
- (6) Dërgesat në trafikun ndërkombëtar, të dërguara në vendet jashtë Bashkimit Evropian, përmbajtja e të cilave i nënshtrohen procedurave doganor dhe të këmbimit valutor, duhet të dorëzohen të hapura dhe së bashku me formularët e nevojshme, ato mund të dorëzohen varësisht nga përmbajtja si letër, dërgesë me porosi (R) dhe prioritet, dërgesa me vlerë përparësi apo si pako/koli.
- (7) Lista e sendeve të ndaluara për transport në trafikun ndërkombëtar postar, si dhe sendeve që mund të transportohen vetëm në kushte të përcaktuara qartë, dhe në përputhje me dispozitat e Konventës Unionit Universal Postar (UPU). Udhëzimet Teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme me Ajër të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, rregulloret për transportin e mallrave të rrezikshëm të Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror dhe rregulloret e tjera përkatëse që rregullojnë këtë zonë janë në dispozicion në faqen e internetit [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com). Lista e artikujve të ndaluar për bartje me shërbim postar mund të kërkohet me kërkesë në çdo zyrë postare, me këtë informatë në dispozicion konsiderohet se dërguesi është në dijeni të këtyre ndalimeve dhe se ai merr përsipër t'i respektojë ato.
- (8) Kafshët e gjalla do të dorëzohen vetëm si dërgesa të regjistruara në shërbimin plotësuese, si të tilla mund të dërgohen:
  - a) bletët, shushunjat dhe krimbat i mëndafshit të manit,
  - b) parazitët dhe shkatërruesit e insekteve të dëmshëm të destinuara për kontrollin e këtyre insekteve që shkëmbehen ndërmjet institucioneve të autorizuar zyrtarisht.

## 2. Trajtimi i dërgesave me tarifë postare të pamjaftueshme

### Neni 25

- (1) Për dërgesat postare (letër dërgesat) për të cilat nuk është paguar tarifë postare e mjaftueshme do të dërgohen në destinacion nëse i plotësojnë kushte të tjera të përcaktuara për pranim, me kusht që marrësit të ngarkohet me tarifën e pa paguar apo ndryshimin e tarifës sipas çmimeve në fuqi.
- (2) Letër dërgesat e dorëzuara në numër të madh për të cilat posta nuk është paguar ose është paguar në mënyrë të pamjaftueshme, do t'i kthehen dërguesit, me kusht që asnjë pullë të mos jetë e vulosur me vulë postare.
- (3) Gjitha dërgesat postare (letër dërgesat) për të cilat nuk është paguar tarifë postare e mjaftueshme duhet të vulosën me shenja të vulës 'T' (*Taxe à payer- të paguhet taksa postare*), e cila vihet në këndin e djathtë të sipërm të faqes së adresës të dërgesave jo mjaft të tarifuara ose të pa tarifuara siç janë letrat dhe kartëpostat, dhe dorëzohen me kusht që marrësi paguan pjesën apo tersin e tarifës së pa paguar.
- (4) Letër dërgesat postare që nuk i plotëson kushtet për pranim dhe dorëzimin do t'i kthehen dërguesit të pa vulosura me vulë datare. Nëse nuk ka adresë dërguesi në këto dërgesa, dërgesat konsiderohen të pa dorëzuara.


## 3. Adresimi

### Neni 26


- (1) Në secilën dërgesë postare duhet të shënohet në mënyrë të lexueshme dhe të qartë adresa e marrësit, e cila duhet të përmbajë të gjitha të dhënat për dërgimin dhe dorëzimin e shpejtë dhe të saktë të dërgesës.
- (2) Për dërgesat postare të regjistruara për të cilat lëshohet vërtetim mbi pranimin e tyre mund të adresohen vetëm në emër të një marrësi i cili mund të jetë person fizikë ose juridik.
- (3) Posta direkte mund të adresohet në disa marrës, me kusht që marrësit të ndodhen në të njëjtën adresë.
- (4) Adresa e marrësit duhet të jetë e shënuar në pjesën e djathtë të faqes së adresës së dërgesës, e cila duhet të jetë paralele me anën e saj të gjatë, e shkruar apo e vënë me etiketë të përforcuar.
- (5) Letër dërgesat e regjistruara, dhe dokumentet përkatëse si p.sh., vërtetimi mbi pranimin e dërgesës nuk mund të plotësohen me laps të thjeshtë.

- (6) Adresa e marrësit duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme. Të dhënat mbi marrësin duhet të jenë të plota dhe të sakta, të shënuara ose përshkruara sipas radhës, ashtu që adresa e marrësit gjatë bartjes së dërgesës të lexohet dhe verifikohet.
- (7) Të dhënat në adresën e dërgesës duhet të jenë të shënuara njëra ndër tjetrën në këtë mënyrë: emri dhe mbiemri i marrësit, rruga, numri i shtëpisë, numri i hyrjes, kati, numri i banesës, vendbanimi, numri postar postës që mbulon adresën e marrësit

a) *Shembull: Adresim i drejtë në trafikun vendor,*



b) *Shembull: Adresim për fahë postar;*



c) *Shembull: Adresim për post restant (qëndron në postë);*



d) *Shembull: Adresim i drejtë në trafikun ndërkombëtar;*



- (8) Numri postar i çdo dërgese është pjesë përbërës në çdo dërgese, ai shërben për ndarje të shpejtë të dërgesave në drejtime të caktuar. Për shkak të lejueshmërisë numri postar shënohet nën të dhënat e adresës me largësi të mjaftuar.
- (9) Të gjitha të dhënat që i përmban adresa e dërgesës si dhe numri i zyrës postare duhet të gjinden në fushën e leximit. Kjo lehtëson leximin e adresës së marrësit gjatë procesit të bartjes si dhe dorëzimit të dërgesave postare. Fusha e leximit është hapësirë e imagjinuar në formë katërkëndëshi kënddrejtë me dimensione 70 x 30 mm. Largësia nga skaji i anës së djathtë të dërgesës deri në brinjën e djathtë të kënddrejtë është 45 mm, ndërsa largësia nga skaji i poshtëm i dërgesës është 20 mm.
- (10) Në dërgesën e cila është e adresuar në emër të marrësit i cili është me qira në këtë adresë, përveç emrit dhe mbiemrit të marrësit duhet të shënohet edhe emri e mbiemri i qiradhënësit p. sh. (*Agim Gashi te Besim Berisha*).
- (11) Në komunikacionin ndërkombëtar dhe vendor, dërgesat postare adresohen me alfabet latin, gjithashtu mund të përdoret alfabeti cirilik i cili është zyrtar në adresën e marrësit.
- (12) Dërgesat që dërgohen me zarfe me pjesë të tejdukshme, duhet të jenë të shtypura në mënyrë që nëpër pjesën e tejdukshme të shihet mirë adresa e marrësit.
- (13) Përveç adresës së marrësit dërguesi ka për detyrë ta shkruaj edhe adresën e vetë në pakon e vogël dhe të gjitha dërgesat e regjistruara.
- (14) Zyra postare e pranimit mund të refuzojë pranimin e dërgesës e cila nuk është adresuar sipas mënyrës dhe rregullave të përmendura më lartë, ndërsa dërgesat e regjistruara nuk i pranon fare.
- (15) Në pjesën e poshtme të djathtë të anës së adresës së dërgesës lejohet ngjitja ose vendosja e adresës së shtypur e marrësit. Për dërgesat kur nuk është e mundur të shënohet në adresën e marrësit, mund të përdoret një etiketë nga kartoni ose nga një material tjetër i përshtatshëm për adresim, me dimensionet më të vogla 90 x 140 mm.

#### 4. Kushtet e përgjithshme për paketimin dhe ambalazhimin

Neni 27

- (1) Paketimi i një dërgesë nënkupton vendosjen e përmbajtjes së dërgesës në mbështjellësin e duhur (zarf, kuti ose të ngjashme. Çdo dërgesë duhet të ambalazhohet dhe të mbyllet në mënyrë të tillë që ti përgjigjet peshës, formës dhe natyrës së përmbajtjes si dhe mënyrës së transportit dhe kohëzgjatjes së tij.
- (2) Drejtoria e PK SHA, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian mund të sigurojë prodhimin e kutive për ambalazhimin e kolive postare, duke përdorur logon e sajë me çmime të pranueshme për shfrytëzuesit e këtij shërbimi.
- (3) Me ambalazhim dhe mbyllje e dërgesave duhet të ruhet përmbajtja, në mënyrë që kolia të mos dëmtohet as nga presioni as nga manipulimet e mëtejshme dhe që të bëjnë të pamundur prekjen e përmbajtjes pa lënë gjurmë të dukshme të dëmtimit të sajë.

- (4) Ambalazhimi dhe mbyllja e kolive duhet të bëhet ashtu që të mos kërcënohet shëndeti i punonjësve si dhe të evitohet çdo dëmtim në raste se përmbajnë sende që mund të dëmtojnë punonjësit e postës, të ndotin apo të dëmtojnë koltitë tjera ose pajisjet postare që ka në përdorim shërbimi postar.
- (5) Çdo dërgesë e pranuar për tu transportuar mbi ambalazhin e saj duhet të ketë një hapësirë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të vendosur shënimet e shërbimit për vendosjen e pullave, shenjave të frankimit apo të etiketave të tjera të shërbimit.

#### 5. Dispozita të veçanta për paketimin dhe mbylljen e dërgesave postare Neni 28

Varësisht prej përmbajtjes së dërgesave postare ato duhet të paketohen si më poshtë:

- (1) Lëndët e ndjeshëm duhet të paketohen individualisht në një kuti të fortë të mbushur me një material të përshtatshëm mbrojtës që do të parandalojë dëmtimin e përmbajtjes.
- (2) Lëngjet dhe substancat e tretshme lehtësisht duhet të mbyllen në enë të padepërtueshëm të cilët, nëse është e nevojshme duhet të vendosen në një kuti të veçantë të ngurtë të mbushur me një material të përshtatshëm mbrojtës i cili mund të thithë lëngun në rast të thyerjes së enës.
- (3) Substancat me yndyrë dhe pak të tretshme duhet së pari të vendosen në një kuti, thes, qese plastike dhe të ngjashme (paketimi i parë) dhe pastaj në një kuti të fortë, e cila duhet të parandalojë rrjedhjet e përmbajtjes nëse ndodh dëmtimi i dërgesës dhe përmbajtjes së saj.
- (4) Dërgesat që përmbajnë sende të paketuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret, si dhe me qarkoret e tjera të UPU, (*kafshë të gjalla, narkotikë, materiale mikrobiologjike infektive, plazma, etj.*) duhet të paketohen në përputhje me këto rregullore. Paketimi i saktë i dërgesave duhet të konfirmohet në dërgesë nga organi i autorizuar.
- (5) Dërgesat e referuara në paragrafin 2, të këtij neni, përveç kafshëve të gjalla, mund të shkëmbehen vetëm midis laboratorëve të njohur zyrtarisht dhe të autorizuar.
- (6) Dërgesa e substancave radioaktive në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar kryhet në përputhje me aktet e UPU-së.

#### 6. Paketimi dhe mbyllja e letër dërgesave dhe pakove me vlerë Neni 29

- (1) Për paketim të letër dërgesës me vlerë duhet të përdoret zarfe special i prodhimit postar i përpunuar nga letra kualitetit të lartë dhe rezistuese ndaje lagështisë dhe dëmtimit eventual gjatë transportit.
- (2) Të gjitha mjetet për paketim të letrës me vlerë duhet të jenë në rregull dhe prej kualitetit të lartë. Letra me vlerë nuk mund të paketohet në mbështjellës të tejdukshëm ose në zarfe me pjesë të dukshme.
- (3) Për mbyllje të letrës me vlerë duhet të përdoret dylli i kuqë me vulë të thatë dh etiketa e sigurisë postare.
- (4) Për shkak të sigurisë së përmbajtjes së letrës me vlerë në mbështjellësin përkatësisht zarfin e letrës me vlerë, nuk mund të bëhen kurrfarë fshirjesh, gërryerjesh, korrigjimesh, heqje vizash etj., si as ndryshime apo nënvizime të pjesëve të caktuara të adresës ose të vlerës së deklaruar, as nuk mund të vihen etiketa ose shenja të ndryshme, përpos etiketave ose shenjave postare.
- (5) Nëse dërgesa me vlerë përmban monedha, për paketimin e dërgesave të tilla duhet të përdoret thes prej materialit të fortë pëlhurë, të cilat duhet të paketohen në mënyrë që ato të mos lëvizin. Kartëmonedhat në një dërgesë me vlerë duhet të mbështillen me letër dhe të lidhen.
- (6) Për dërgesat me vlerë që përmban sende të tjera që nuk mund të vendosen në zarf të veçantë të siguruar nga PK, SHA, në këto raste duhet të përdoren kutitë e përshtatshme të forta, qese najloni, etj.
- (7) Shirin ngjitës me emërtim të PK SHA, përdoret për të mbyllur dërgesat dhe pakot me vlerë. Dërguesi detyrohet të vej gjurmët e vulës ose nënshkrimin e tij në shirin ngjitës. Nëse dërguesi përdor shirin ngjitës me logon e tij për mbyllje e dërgesave me vlerë, në këtë rast nuk është i detyruar të vendos gjurmët e vulës dhe nënshkrimin e tij.

- (8) Për të mbrojtur dhe siguruar më mirë përmbajtjen e pakos me vlere , rekomandohet që dërguesi, përveç shiritit ngjitës ose etiketën siguruese postare , të përdorë edhe litar, lidhëse etj.

#### 7. Hapja dhe ripaketimi i dërgesave postare Neni 30

- (1) PK SHA, mund të hapë dërgesën dhe të shikojë përmbajtjen pa pëlqimin e dërguesit ose marrësit dhe të përpilojë procesverbal, në rastet e mëposhtme:
- kur dërgesa postar nuk mund t'i dorëzohet marrësit ose t'i kthehet dërguesit (dërgesat e pa dorëzuara),
  - kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se dërgesa postar përmban përmbajtje të ndaluar,
  - kur dërgesa postar është dëmtuar në atë mënyrë sa që përmbajtja e sajë të rrezikohet,
  - kur dërgesa postare në trafik ndërkombëtar i nënshtrohet zhdoganimit në përputhje me rregulloret doganore.
- (1) PK SHA, menjëherë do të hapë, inspektojë dhe regjistrojë statusin dhe përmbajtjen e dërgesës, dhe ripaketimin nëse:
- nëse ekziston dyshimi dhe konstatohet përmbajtja e dërgesës është dëmtuar ose zvogëluar,
  - pas pranimit , dhe para dorëzimit të dërgesës, konstatohet që përmbajtja e dërgesës është e prishur ose nuk është e paketuar siç duhet duke e rrezikuar përmbajtjen e saj dhe dërgesave tjera.

### V. PAGESAT PËR SHËRBIME POSTARE

#### 1. Dispozitat e përgjithshme Neni 31

- (1) Çmimi për shërbimin universal dhe shërbimet plotësuese (*këtu e tutje: tarifa postare*) tarifave sipas Listës së Çmimeve.
- (1) Taksën postare në parim e paguan dërguesi paraprakisht, përveç nëse këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme ose kontrata e lidhur mes shfrytëzuesve të shërbimeve dhe PK SHA. nuk është specifikuar ndryshe.
- (2) Kur përcaktohet me ligj të veçantë për pagesë shtesë, dërguesi është i detyruar, përveç taksës postare, të paguajë shumën e përcaktuar me atë ligj.
- (3) Për dërgesat për të cilat nuk është paguar tarifë postare ose paguar tarifë jo e mjaftueshme PK SHA, nga marrësi kërkon ta paguaj taksën postare të pa paguar ose jo mjaftueshëm te paguar të përcaktuar nga Lista e Çmimeve (*si: porto- taksë postare*), ose nga dërguesi në rast se dërgesa i kthehet atij.
- (4) Me marrjen e dërgesës 'Post restant' ose 'Qëndron në postë', marrësi duhet të paguajë tarifën postare e paraparë nga Çmimorja për shërbimet postare universale.
- (5) Në trafikun ndërkombëtar, pagesa e tarifës postare mund të bëhet duke shkëmbyer një kupon përgjigjeje ndërkombëtare. Kuponi i përgjigjes ndërkombëtare shitet sipas Listës së Çmimorës në fuqi. Kuponi i përgjigjes ndërkombëtare mund të shkëmbehet me pulla postare i vlefshëm për dërgimin e një letre me prioritet të shkallës së parë të peshës në trafikun ndërkombëtar, pavarësisht nga cilin vend është lëshuar.
- (6) Kupon përgjegjës ndërkombëtare shtypet në letër që përmban në filigramë të UPU dhe shënimin 'UPU' me shkronja të mëdha, nën kujdesin e Byrosë ndërkombëtare dhe u shpërndahen operatorëve publik kudo në botë sipas kërkesave të tyre. Kuponët përgjegjës ndërkombëtar u shpërndahen për shitje zyrave postare. Ato janë të qarkullueshme në të gjitha vendet e UPU-së, pavarësisht se në cilin vend janë blerë.
- (7) Zyra e postës që pranon kuponin përgjegjës ndërkombëtar e vulosë atë me vulën datare postare në anën e djathtë. Kuponin përgjegjës ndërkombëtar të vulosur në të dy anët e saj, nuk janë të vlefshme për pagimin e tarifave të shërbimit postar.
- (8) Në qoftë se një dërgues dëshiron të dërgojë një dërgesë postare të çdo lloji dhe me shërbime të veçanta, ai mund ta paguajë tarifën e shërbimit me kupon përgjigjeje ndërkombëtare në sasi e vlerë sa të plotësohet tarifa e shërbimit.

#### 2. Shënim i taksës postare Neni 32

- (1) Shënimi taksës postare letër postës përdoren pullat postare dhe me shenja të makinave të frankimit, të pranuar zyrtarisht dhe nën kontrollin e përhershëm të Drejtorisë së Postës të Kosovës, si dhe me shenjat tjera të parapara me aktet e UPU-së.
- (2) Shenjat e frankimit duhet të tregojnë zyrën e originës të shtypur me shkronja latine, dhe tarifa e shërbimit duhet të tregohet me shifra. Shenjat e frankimit në çdo rast duhet të jenë me ngjyrë të kuqe të çelur.
- (3) Kur konstatohen dërgesa të tarifuar me pulla të vendeve të tjera, pulla të përdorura apo të hequra nga qarkullimi si dhe pulla të tjera të pa vlefshme për tarifim, atyre u vihet shenja 'T', dhe vula datare postare, por jo mbi pullat e vendosura.
- (4) Në këtë rast dërgesa dërgohet për në destinacion, me detyrimin që marrësi të paguaj tarifat e pranimit. Çdo dërgesë postare pa shenjën 'T', konsiderohet e tarifuar në rregull dhe dërgohet në destinacion.

### 3. Pullat postare

#### Neni 32

- (1) Pulla postare është vlerë e cila shfrytëzohet për të treguar pagimin e taksës postare, dhe vendoset në anën e djathtë të këndit të sipërm të faqes së adresës së dërgesave. Për pagimin e taksës postare gjithmonë përdoren pullat me vlerë më të lartë ose vlerë më të madhe.
- (2) Nëse një pullë postare e pavlefshme në Republikës së Kosovës është e vendosur në dërgesë, konsiderohet se tarifa postare nuk është paguar.
- (1) Kushtet, mënyra e lëshimit dhe përdorimit të pullave postare rregullohen me Rregulloren për pullat postare.

### 4. Makina e frankimit

#### Neni 33

- (1) Makinat për frankim, janë pajisje me të cilat bëhet frankimi i dërgesave postare duke shtypur shumën e taksës postare dhe vulosjen e dërgesës.
- (2) Makinat e frankimit zakonisht përmban gjurmët e pullës postare, datën, vendin dhe logon e operatorit publik.
- (3) Makinat e frankimit janë shumë të përshtatshme për t'u përdorur nga shfrytëzuesit e mëdhenj të cilët përpunojnë dhe dorëzojnë numër të madh të dërgesave postare.

### 5. Vula datare postare

#### Neni 33

- (1) Vula datare postare përdoret për vulosjen e dërgesave postare, dokumenteve manipulative në pranim dhe në arritje. Vulosja e dërgesave postare bëhet me kujdes dhe pa gabime mbi një shtresë të butë duke mbuluar 3/8 e pullës postare. Vula datare postare duhet te përmbajë:
  - a) Emrin e zyrës së postës;
  - b) Shenjën që tregon vendin e punës;
  - c) Datën, muajin dhe vitin;
  - d) Orën e pranimit;
  - e) Numrin e kodit postar.

### 6. Shenjat në dërgesë për pagesat e tarifës postare

#### Neni 34

- (1) Pagesa e tarifës postare në dërgesat e postës së letrave është e përcaktuar me aktet e UPU-së, me Rregulloret për Shërbimet Postare, Ligjin, si dhe me këto Terme dhe Kushte të Përgjithshme.
- (2) Në dërgesat nga shfrytëzuesit e mëdhenj që pranohen nga institucione të ndryshme dhe me kontrata tarifohen sipas tarifave të miratuara duke aplikuar vulën e posaçme në këndi e djathtë sipër adresës 'TARIFË E PAGUAR' ose shkurt 'E PAGUAR', për brenda vendit dhe 'TAXIS PERÇUE/ POSTAGE PAID', për trafikun ndërkombëtar.



- (3) Dërgesat e postës së letrave mund të tarifohen edhe me makina frankimi, ku shenjat e makinave të frankimit duhet të jenë të pranuar zyrtarisht dhe nën kontrollin e përhershëm të Drejtorisë së Postës të Kosovës. Shenjat e frankimit duhet të tregojnë zyrën e originës të shtypur me shkronja latine, dhe tarifa e shërbimit duhet të tregohet me shifra. Shenjat e frankimit në çdo rast duhet të jenë me ngjyrë të kuqe të çelur.
- (4) Kur konstatohen dërgesa të tarifuara me pulla të vendeve të tjera, pulla të përdorura apo të hequra nga qarkullimi si dhe pulla të tjera të pa vlefshme për tarifim, atyre u vihet shenja 'T', dhe vula datare postare, por jo mbi pullat e vendosura. Në këtë rast dërgesa dërgohet për në destinacion, me detyrimin që marrësi të paguaj tarifat e pranimit. Çdo dërgesë postare pa shenjën 'T', konsiderohet si e tarifuar në rregull dhe dërgohet në destinacion.

#### 6. Dërgesat e përjashtuara nga pagesat postare

Neni 35

- (1) Dërgesat e përjashtuara nga pagesat postare përbajnë, ne anën e adresës, ne pjesën e djathtë lart shënimet të cilat mund të jenë edhe të përkthyer: '*Services des postes*' (Shërbimi zyrtar postar) ose një shënim të ngjashëm, për dërgesat e përjashtuara nga pagesat '*Service des prisonniers de guerre*' (Shërbime për robërit e luftës) dhe '*Cecogrammes*' (Sekogramme - literature për të verbrit).

#### 7. Magazinimi

Neni 36

- (1) Marrësi i shtypshkrimeve, postës direkte, kolive, dërgesave EMS, e-commerce dërgesave nga blerjet Online duhet të paguajë taksën e magazinimit sipas tarifës në fuqi, nëse ai nuk e ka marrë dërgesën brenda afateve të parapara.
- (2) Taksa e magazinimit fillon të llogaritet prej së nesërme pas lënies së raportit mbi arritjen e dërgesës. Në afatin për llogaritjen e magazinimit nuk llogariten ditët jo pune, festat, si dhe dita kur është lënë raporti.
- (3) Taksa postare e magazinimit paguhet me pullë postare, që vendosen në pjesën e prapme të dërgesës, si dhe në pjesën e prapme të flete përcjellëses për paket dhe bëhet zhvlerësimi i tyre.
- (4) Pagesa e magazinimit për dërgesat për të cilat posta doganore ka dërguar një thirrje për paraqitjen e dokumenteve për inspektimin doganor, do të fillojë brenda dhjetë (10) ditëve, nga dita e dërgimit të ftesës/raportit për paraqitje në postën doganore.
- (5) Të gjitha dërgesat në masë më të madhe se 500 gram, magazinohen/ruhen në zyrat postare të dedikuara për këto shërbime.

#### 8. Kthimi i taksës postare

Neni 37

- (1) PK SHA, do t'i kthejë dërguesit tarifën postare të ngarkuar për çdo lloj të shërbimit postar universal në trafikun ndërkombëtar nëse ato nuk i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në rregulloret për sigurinë e dërgesave postare, procedurave të kontrollit doganor, pra kur ato nuk plotësojnë kushtet e sigurisë për dërgimin në trafikun ndërkombëtar. Në këtë rast, dërguesit i kthehet shuma e inkasuar për shërbimin e paguar.
- (2) Kur shërbimi postar nuk është kryer (dërgesa e humbur apo e dëmtuar), ofruesi i shërbimit postar është i detyruar që dërguesit të dërgesës postare të i paguaj tarifën adekuate (të parapara sipas Rregulloreve të UPU dhe Ligjit) të dëmshpërblimit si dhe shumën e tarifës së paguar për dërgesën e humbur.
- (3) Në rast se ofruesi i shërbimit postar nuk ia paguan dërguesit ose një personi tjetër të autorizuar dëmin brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e përmbylljes së reklamacionit (ankesës), atëherë procedura e kompensimit mund iniciohet në gjykatën kompetente.
- (4) Nëse dërgesa e humbur ose një pjesë e saj është gjetur pas pagesës së kompensimit, ofruesi i shërbimit postar është i detyruar të informojë dërguesin apo një person tjetër të autorizuar.

9. Pagesat nga trafiku ndërkombëtar ardhje  
Neni 38

- (1) Për dërgesat e pranuar nga trafiku ndërkombëtar ne ardhje, përveç taksës postare të paguar në përputhje me administratën doganore dhe rregulloret e veçanta, përcaktohet pagimi e taksës doganore, taksës speciale ose akcizës, dhe tatimin në vlerën së shtuar (TVSH). Marrësi i dërgesës, përmes PK SHA, njoftohet për paraqitje për pranimin e dërgesave të ndalura për pagesë dhe procedura tjera doganore, si:
  - a) tarifën për paraqitjen e dërgesës për zhdoganimin,
  - b) tarifa për dërgimin e një thirrje për paraqitje në zyrën doganore, e cila dërgohet si dërgesë e regjistruar me shërbim të veçanta.
  - c) magazinimin.
- (2) Marrësi ka të drejtë, para se të paguajë taksën doganore, taksën e veçantë ose akcizën dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, të njihet me përmbajtjen e deklaratës doganore që shoqëron dërgesën dhe shumën me të cilën ngarkohet ngarkesa.

**VI. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DËRËZIMIN E DËRGESAVE POSTARE**

1. Dispozitat e përgjithshme për dorëzimi dhe shpërndarjen e dërgesave postare  
Neni 39

- (1) Me dorëzim, nënkuptohet dorëzimi i dërgesave në zyrën postare/ hapësirat e parapara për shpërndarje dhe dorëzim si dhe përmes faheve postar. Ndërsa me 'shpërndarje' nënkuptohet dorëzimin e dërgesave në adresën e marrësit, në kuti shtëpiake të marrësit ose lokalet e biznesit.
- (2) Dërgesat e thjeshta postar, si rregull dorëzohen me anë të futjes (vendosjes) në kutia postare shtëpiake/banesore.
- (3) Për e dërgesat regjistruara postare për të cilat është lëshuar dëftesë e pranimit, dërgesat i dorëzohen personalisht marrësit ose personit të autorizuar.
- (4) Nëse për dërgesat postare për të cilat është lëshuar dëftesë pranim (*me shërbime të veçanta*) nuk mund t'i dorëzohet personalisht marrësve, ato mund t'i dorëzohen dikujt nga anëtari e rritur të familjes, personave të punësuar në shtëpinë e familjes, biznesit të marrësit, ose personave të autorizuar.
- (5) Anëtar i rritur i familjes do të thotë bashkëshorti, prindi dhe fëmija, vëllai dhe motra mbi moshën 16 vjeç, dhe çdo i afërm tjetër mbi moshën 16 vjeç, që jeton me marrësin në një familje të përbashkët.
- (6) Një person i punësuar nënkupton çdo person mbi moshën 18 vjeç, i cili është i punësuar në ambientet shtëpiake ose afarizëm të marrësit.
- (7) Nëse dorëzimi nuk është i mundur në përputhje me parashikimet e këtyre kushteve, marrësi do të njoftohet për arritjen e dërgesës përmes raportit , duke treguar kohën dhe vendin e tërheqje të dërgesës. Nëse marrësi nuk e merr dërgesën brenda kohës së caktuar, dërgesa i kthehet dërguesit.
- (8) Raporti i lënë marrësit ose personit të autorizuar për të tërhequr dërgesën në përputhje me këto kushte të përgjithshme, nënkupton se shërbim postar është kryer në rregull.
- (9) Personat nga këto kushte të përgjithshme mund të refuzojnë pranimin e dërgesave postar, me përjashtim nëse nuk parashikohet ndryshe me ndonjë ligj të veçantë ose rregullore tjetër PK SHA. Dërgesa pas refuzimit duhet të përmbajë shënimet: datën e refuzimit, nënshkrimin e marrësit, vulosjen e saj, dhe më pastaj i kthehet dërguesit me shënim 'REFUZON PRANIMIN'.
- (10) Dërgesat për personat juridik i dorëzohen personit të autorizuar për të marrë dërgesat për atë person juridik ose personit të autorizuar nga marrësi. Nëse personi juridik pushon së ekzistuari, dërgesat i dorëzohen pasardhësit të tyre juridik në bazë të një vendimi të autoritetit kompetent.

- (11) Dërgesat adresuara për personi fizik që kryen një veprimtari *biznesi (zejtarë, tregtarë individualë, mjekë, noterë, etj.)*, dorëzohen personalisht te marrësi ose tek personi i autorizuar për të pranuar dërgesat. Dërgesat adresuar për avokat mund t'i dorëzohen edhe personit të punësuar dhe të autorizuar nga kjo zyrë juridike.
- (12) Dërgesat postare për personat fizikë që dërgesat i kanë të adresuara në emër të bizneseve e tyre (*hotele, vendpushime, spitale, institucione, etj.*) dorëzohen personave juridik/pronarëve të këtyre bizneseve apo personave të autorizuar nga ta.
- (13) Nëse dërgesa nuk mund t'i dorëzohet marrësit ose t'i kthehet dërguesit, PK SHA, ai është i detyruar të dhe e obliguar që këto dërgesa t'i trajtojë si dërgesa të pa dorëzuara.
- (14) Marrësi, si dhe dërguesi në rast të kthimit të dërgesës, mund të refuzojnë pranimin e dërgesës

## 2. Autorizimi Neni 40

- (1) Shfrytëzuesit mund të autorizojnë persona të tjerë për shfrytëzimin e të gjitha shërbimeve postare. Shfrytëzuesit e shërbimeve postare, pranimin e dërgesave postare të regjistruara mund ta bëjnë edhe nëpërmes personave të autorizuar. Për denjën e autorizimit përveç dispozitave ligjore dhe atyre të përgjithshme vlen edhe me sa vijon:
  - a) autorizimi nuk mund t'i jepet personit i cili është analfabet ose nuk mund të nënshkruaj;
  - b) shfrytëzuesi i shërbimeve postare me një autorizim mund t'i autorizoj jo më shumë se tre persona që në emër të tij të marrin dërgesat postare, telegramet dhe raportet për tërheqje të dërgesave;
  - c) autorizimi i individit, përkatësisht revokimi i këtij autorizimi, duhet të jetë i vërtetuar nga organet kompetente shtetërorë ose nga organizata e PK SHA;
  - d) autorizimi duhet të deponohet në njësinë e rrjetit postare, në të cilën i autorizuari do të marrë dërgesat postare, telegramet, fletëthirrjet telefonike,
- (2) Çdo person fizik apo juridik mund të kërkojë që dërgesat postare të arritura në adresë të tij, ti tërheq nga zyra e postës me më së tepërmi tre persona të autorizuar prej tij sipas formularit (P-15 'Autorizimi'). Personi i autorizuar është i detyruar të tregoj identitetin e tij me dokumente zyrtare identifikuese të njohura me ligj.
- (1) Autorizimet e lëshuara personat juridik për tërheqjen e dërgesave postare të porositura, të letrave me vlerë të deklaruar dhe të pakove me ose pa vlerë të deklaruar, duhet të jenë të nënshkruara nga drejtuesit kryesorë të tyre.
- (2) Autorizimet e lëshuara nga persona privat, nënshkruhen vetëm nga personi që ka lëshuar autorizimin. Njohja e autorizimit bëhet me nënshkrimin e punonjësit të postës i cili e regjistron atë në librin e autorizimeve sipas (formularit P-18), që mbahet në dy kopje, njëra ruhet në zyrë postare kurse tjetra i jepet personit të autorizuar. Autorizimet për tërheqjen e postës janë tri llojesh:
  - a) Autorizim vetëm për një tërheqje;
  - b) Autorizim i vlefshëm për tërheqje për një periudhë të caktuar;
  - c) Autorizim i vlefshëm për një periudhë të gjatë por jo më shumë se një vit kalendarik.

## 3. Vërtetim i identitetit Neni 41

- (1) Dërguesi, marrësi ose personi tjetër i autorizuar duhet të vërtetojë identitetin e tij me dokumentet vijuese:
  - a) Letërnjoftimi;
  - b) Pasaporta;
  - c) Kartë identiteti postare;
  - d) Dokument tjetër që ligjërisht vërteton identitetin personal;
  - e) Deklarata e dy dëshmitarëve identiteti i të cilëve mund të vërtetohet me dokumentet e lartpërmendura

## 4. Shpërndarja e dërgesave postare Neni 42

- b) pesë (5) ditë pune – për gjitha dërgesat e adresuara në rajonin rurale , afatet llogariten pas lënies së raportit/ njoftimit për mbërritjen e një dërgesë;
  - c) tridhjetë (30) ditë kalendarike - për dërgesat e adresuara 'post restant',
- (2) Në përjashtim të këtyre kushteve pakot të arritura nga trafiku i postës ndërkombëtare mund të tërhiqen brenda tridhjetë (30) ditëve të punës.
  - (3) Afatet e përcaktuara në parashikuara fillojnë të llogariten nga dita e lënies së njoftimit/raportit mbi arritjen e dërgesës.
  - (4) Për dërgesat postare për të cilat detyrimisht posta obligohet të bëjë tentimin e dytë për dorëzim, afatit për marrjen e dërgesave vlejnë në paragrafin 1, pika e këtij neni.

#### 6. Konfirmimi për marrje të dërgesave Neni 46

- (1) Marrësi i dërgesës i cili është person fizik konfirmon pranimin e dërgesave me nënshkrimin e tij në dokumentin e përkatëse, ndërsa për pakot nga trafiku ndërkombëtar shënohet koha e dorëzimit (orë dhe minutat).
- (2) Kur marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë për shkak të një paaftësie fizike, punonjësi i PK SHA, e shënon emrin dhe mbiemrin e tij dhe arsyen se pse marrësi nuk e ka mundur ta vendos nënshkrimin e tij.
- (3) Në rast se dërgesa merret në emër të marrësit nga përfaqësuesi i tij ligjor, personi i autorizuar, anëtar i familjes ose një punonjës i familjes i punësuar nga marrësi, punonjës i PK SHA, shënon në dokumentet përkatëse marrëdhënien me marrësin.
- (4) Dorëzimi e dërgesave në emër të organeve shtetëror ose organeve tjera, personat fizikë të angazhuar në veprimtarinë e regjistruar (*zejtarë, tregtarë, individë, mjekë, avokatë, etj.*), dorëzimi mund të kryhet përmes personave të autorizuar, qoftë në lënien e raportit për arritjen e dërgesës apo dorëzimin e dërgesës.
- (5) Dorëzimi dërgesës për personat fizikë që kryejnë një veprimtari të regjistruar (*zejtarë, tregtarë, mjekë, noterë, etj.*) konfirmohet personalisht nga marrësi ose një person i autorizuar me nënshkrimin e tij dhe gjurmët vulës. Nëse marrësi nuk i vendos gjurmët e vulës, punonjësi i PK SHA, i shënon arsyet pse nuk është bërë kjo (*mungesë e vulës, e përdorshme, defekt etj.*).

#### 8. Ridërgim i dërgesave postare Neni 47

- (1) PK SHA, i ridërgon dërgesat postare në bazë të kërkesës me shkrim të dërguesit ose marrësit, si shërbime plotësues të përmendur nga këto kushte dhe terme të përgjithshme, të parapara para dorëzimit të dërgesës
- (2) PK SHA, letër posten e ridërgon falas në një adresë të re marrësit, nëse marrësi udhëtuar ose është shpërngulur, dhe e konstaton adresën e tij të re apo ia kthen dërguesit dërgesën.
- (3) Ridërgimi dërgesës postare (*letër dërgesave*) në adresën e re nga paragrafi 1, i këtij neni kryhet me kusht që dërguesi të mos ketë ndaluar ridërgimin e dërgesës.
- (4) PK SHA, i dërgon marrësit dërgesën postar në një adresë të re, me kërkesë me shkrim të dërguesit ose marrësit, të paraqitur para dorëzimit të dërgesës, e cili shërbim tarifohet sipas tarifave postare për shërbimit plotësuese, shërbime të parapara nga nenet 22, dhe 23, të këtyre Termeve dhe Kushteve të Përgjithshme.
- (5) Ridërgimi i dërgesave postare në një vend tjetër të destinacionit do të kryhet vetëm nëse dërgesa që do të dërgohet plotëson kushtet në aspektin e mallrave të lejuar për atë vend të destinacionit.

#### 9. Kthimi i dërgesave Neni 48

- (1) Dërgesat postare i kthehen dërguesve në rastet e mëposhtme:
  - a) nëse marrësi nuk pranon ta marrë dërgesën;

- b) nëse pas njoftimit/raportit mbi arritjen e dërgesës, marrësi nuk e ka tërhequr dërgesën;
  - c) nëse konstatohet se marrësi është shpërngulur;
  - d) nëse marrësi është i panjohur në atë adresë,
  - e) nëse marrësi ka vdekur;
  - f) nëse adresa e shënuar është e pa mjaftueshme për dorëzim,
  - g) nëse marrësi përdor shërbimin falas të kthimit (ERS);
  - h) nëse përmbajtja e dërgesës është e ndaluar,
  - i) nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret doganore;
  - j) nëse nuk i plotëson kërkesat e sigurisë për transportin në trafik ndërkombëtar;
  - k) nëse nuk i plotëson kushtet për marrjen e dërgesave në trafik ndërkombëtar.
- (2) Përveç rasteve nga paragrafi 1, i këtij neni, dërgesa kthehen edhe në rastet kur nuk është paguar ose jo mjaftueshëm është paguar tarifa postare nga këto Terme dhe Kushte të përgjithshme.
- (3) Përjashtimisht, shtypshkrimet dhe posta e direkte mund t'i dorëzohen një anëtar të familjes së marrësit të ndjerë, në mënyrë që dërgesat të mos kthehen.
- (4) Për pakot, dhe dërgesat EMS, për shkak të pamundësisë për t'i dorëzuar marrësit, dërguesit do të ngarkohet me tarifën e kthimi sipas çmimoreve në fuqi, si dhe për shërbimet tjera nëse shfaqen si ripaketim, magazinimin, etj.
- (5) PK ShA, tregon në mbështjellës të dërgesës arsyen e kthimit të dërgesës.
- (6) Marrësit e dërgesave të cilët shfrytëzojnë të drejtën e shërbimit të kthimit të dërgesave pa pagesë (IBRS), mund ta bëjnë dorëzimin e tyre në çdo zyrë postare.

## 5. Afatet e dorëzimit

### Neni 49

- (1) Në afatet e dorëzimit të dërgesa me shërbime të regjistruara do të konsiderohen të dorëzuar në momentin kur i është dorëzuar marrësit ose kur është bërë përpjekje/ tentim dorëzimi në adresën e marrësit. Koha e dorëzimit vërtetohet në bazë të gjurmëve të vulës në dëftese mbi pranimin e dërgesës, përkatësisht në dërgesë kur nuk lëshohet dëftese pranimi.
- (2) Dërgesat e thjeshtë do të konsiderohen të dorëzuar në momentin kur është vendosur në fahë postar, post restant, magazinim etj.
- (3) Gjithashtu, brenda afateve të dorëzimit konsiderohen rastet kur marrësi ka kërkuar që dërgesa të qëndroj në postë, të mos dorëzohet ose të dorëzohet në adresë tjetër që e përcakton, dërgesa konsiderohet të dorëzuar kur në momentin kur dorëzohet në adresën e përcaktuar nga dërguesi.

#### a) Afati i dorëzimit të dërgesave në trafikun e postës vendore:

Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)		Objektivi (në përqindje sipas afatit)
Brenda për brenda qytetit	D + 1	95 %
	D + 2	5 %
Ndërmjet qyteteve/regjioneve	D + 1	85 %
	D + 2	15 %
Në fshatra/vendbanimet me të largëta rurale	D + 2	60 %
	D + 3	20 %
	D + 4	20 %

#### b) Afati i dorëzimit të dërgesave në trafikun e Postës ndërkombëtare:

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje kumulative)
Vendet e BE (Poste Evropë) dhe rajonit SEE1	D + 3	85 %
	D + 5	97 %
Vendet e Tjera (UPU):		
Vendet e Rajonit të Mesdheut (përveç vendeve të BE)	D + 5	85 %
Vendet e Amerikës së Veriut	D + 6	85 %
Vendet e tjera të Amerikës, Azi dhe Oqeani	D + 8	85 %
Vendet Afrikës	D + 9	85 %

- (3) Në afatet e dorëzimit nuk përfshihen:
- dita e pranimit të dërgesës;
  - kohën e vonës për shkak të adresës së gabuar dhe jo të plotë të marrësit,
  - koha e vonuar për shkak të forcës madhore,
  - ditët jo-pune dhe festave në vendin tonë dhe në vendet e destinacionit,
  - ditët e kaluara në procedurë doganore,
  - nëse dërgesa është pranuar ose futur në kutinë e postare pas afatit të përcaktuar për zbraze.
- (4) Dërgesat postare të pa dorëzuara konsiderohen të gjitha dërgesat e postare të cilat nuk ka qenë e mundur ti dorëzohen marrësve apo ti kthehen dërguesve të tyre.
- (5) PK SHA, dërgesat postare të pa dorëzuara i ruajnë për një periudhë kohore jo më shumë se 2 muaj. Me kalimin e këtij afati formohet një komision për të kontrolluar përmbajtjen e tyre dhe me qëllim që të gjenden mundësit e dorëzimit të tyre marrësve ose dërguesve. Në përfundim të kontrollit të dërgesave postare, komisioni mban një procesverbal në të cilin shënohen vlera dhe sendet me vlerë që mund të gjenden në përmbajtje të tyre. Dërgesat që nuk përmbajnë sende të rëndësishme kur marrësi dhe dërguesi i tyre mbeten të pa njohur asgjësohen nga komisioni duke u djegur ose propozur. Të hollat dhe sendet me vlerë si dhe dokumente me rëndësi që nuk mund t'iu dorëzohen personave që u përkasin, ruhen në dispozicion të marrësit dhe dërguesit deri në një (1) vit. Në mbarim të këtij afati të hollat arkëtohen në buxhetin e PK SHA, ndërsa dokumentet asgjësohen nga komisioni me procesverbal.
- (6) Për dërgesat nga trafik ndërkombëtar, zbatohet procedura e parashikuar në akte të UPU-së, dhe rregulloreve doganore.

## VII. PARASHTRIMI I ANKESAVE PËR SHËRBIMET POSTARE

Neni 50

- (1) Shfrytëzuesit e shërbimeve postare mund të paraqesin ankesë me shkrim PK SHA, për shërbimet postar në rast:
- të humbjes së dërgesave postare, ose dëmtimit dhe reduktimit të përmbajtëse;
  - tejkalimit të afatit të bartjes - transportit dhe shpërndarjen e dërgesave postare;
  - në rastet kur shërbimi postar nuk është realizuar fare, ose nuk është realizuar në mënyrë të plotë.
- (2) Shfrytëzuesit e shërbimeve postare mund të paraqesin ankesë në afat brenda tre (3) muajve nga dita e postimit të dërgesave postare në trafik vendor dhe brenda gjashtë (6) muajve në trafikun ndërkombëtar.
- (3) Në rast të dëmtimit apo përmbajtjes të reduktuar të dërgesës postare, marrësi ose personi tjetër i autorizuar duhet të paraqesë reklamacion menjëherë pas dorëzimit të dërgesave postare.
- (4) Përgjashtim nga paragrafi 2, i këtij neni, reklamacioni për shkak të dëmtimit apo përmbajtjes së reduktuar të dërgesës postare, mund të paraqitet pas dorëzimit të dërgesës postare vetëm nëse marrësi parashtron dëshmi se dëmtimi apo përmbajtja e reduktuar e dërgesës postare nuk kanë ndodhur pas dorëzimit të dërgesës.
- (5) PK, SHA, duhet të paraqesë përgjigje me shkrim për shërbimin postar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së reklamacionit në trafik vendor, ose brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të reklamacionit në trafikun ndërkombëtar.
- (6) Në përgjigjen me shkrim të ofruesit të shërbimit postar, shfrytëzuesi i shërbimeve postare ka të drejtë të paraqesë ankesë komisionit për ankesat e konsumatorëve në ofruesin e shërbimit postar brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e përgjigjes me shkrim. Komisioni për ankesat e konsumatorëve të shërbimeve postare është i detyruar të paraqesë përgjigje me shkrim për shërbime postare brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e ankesës së tij.
- (7) Ofruesi i shërbimit postar si pjesë e Termave dhe Kushteve të Përgjithshme të ofrimit të shërbimeve universale postare, duhet të publikojë procedurat për zgjidhjen e ankesave (reklamacioneve) të shfrytëzuesve të shërbimeve postare lidhur me ofrimin e shërbimeve postare. Procedura për paraqitjen e ankesave dhe zgjidhjen e tyre, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligji në fuqi për shërbimet postare dhe rregulloreve tjera, të jenë transparente, objektive, jo

diskriminuose, të thjeshta dhe në dispozicion për publikun dhe për gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve postare me çmim të volitshme.

- (8) Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet konsumatorit dhe PK SHA, në lidhje me zgjidhjen e ankesës, ankuesi mund të paraqesë kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në Autoritet (ARKEP) brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e përgjigjes me shkrim të Komisionit të Ankesave të Konsumatorëve të paraparë nga këto terme dhe kushte të përgjithshme.

### VIII. PËRGJEGJËSIT DHE DËMSPERBLIMET

#### 1. Realizimi dëmshpërblimeve dhe format e kompensimit në trafikun vendor Neni 51

- (1) Dërguesi ose personi i autorizuar mund të paraqesë ofruesit të shërbimit postar kërkesën për kompensim brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit mbi zgjidhjen e ankesës/reklamacionit përkatësisht pranimit të njoftimit për pranimin e fajësisë.
- (2) Ofruesi i Shërbimit postar është i detyruar që dërguesit ose një personi tjetër të autorizuar për të paguar kompensimin e dëmit për dërgesat në trafikun vendor ashtu siç, është paraparë me nenin 47, paragrafin 2, të ligjit dhe atë për.
- 2.1 humbje apo dëmtim të plotë;
- 2.1.1. dërgesa të regjistruara - në pesë fshin e shumës tarifës së paguar për shërbimet postare,
- 2.1.2. dërgesat me vlerë të deklaruar - në sasinë e vlerës së deklaruar dhe taksën postare;
- 2.2 dëmtim i pjesshëm apo reduktimit të përmbajtjes:
- 2.2.1. dërgesat e regjistruara - shumën që korrespondon me vlerën reale të dërgesës së dëmtuar ose përmbajtjen reduktuar, së paku - pesë fshin e shumës tarifës së paguar për shërbimet postare;
- 2.2.2. dërgesat me vlerë të deklaruar - në shumën që korrespondon me vlerën reale të përmbajtjes së dëmtuar ose të reduktuara të dërgesës dhe më së tepri deri në vlerën e shënuar;
- 2.3. Për tejkalim të afatit kohor për shpërndarjen e dërgesave - në trefishin e shumës tarifës së paguar për shërbimet postare.
- (3) Nëse shërbimi postar nuk është kryer, ofruesi i shërbimit postar është i detyruar të kthejë tarifën e paguar për shërbimin postar.
- (4) Në rastet e përmendura në paragrafin 2, të këtij neni, ofruesi i shërbimit postar duhet, përveç kompensimit të kthejë edhe shumën e tarifës së paguar për reklamimin e dërgesës dhe tarifën për shërbimin postar.
- (5) Në rast se ofruesi i shërbimit postar nuk paguan dërguesit ose një personi tjetër të autorizuar dëmin brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës sipas paragrafit 1, të këtij neni, procedura e kompensimit mund iniciohet në gjykatën kompetente.
- (6) Nëse dërgesa e humbur ose një pjesë e saj është gjetur pas pagesës së kompensimit, ofruesi i shërbimit postar është i detyruar të informojë dërguesin apo një person tjetër të autorizuar.
- (7) Nëse dërguesi ose ndonjë person tjetër i autorizuar kërkon dorëzimin e dërgesës së gjetur, detyrohet për të kthyer shumën e kompensuar, në të kundërtën ofruesi i shërbimit postar ka të drejtë për të shkatërruar dërgesën, ose për të shitur përmbajtjen e saj.

#### 2. Realizimi dëmshpërblimeve dhe format e kompensimit në trafikun ndërkombëtar Neni 52

- (1) Për dëmshpërblimet në trafikun ndërkombëtar do të aplikohen dispozitat dhe aktet të nxjerra nga UPU-ja. Ofruesi i shërbimit postar PK SHA, përmes këtyre Termave dhe Kushteve të përgjithshme të ofrimit të shërbimit universal postar përcakton procedurat e kompensimit të dëmeve për dërgesat postare në trafikun postar ndërkombëtar.

Letër dërgesa të regjistruar	30 DTS + taksa postare për shërbimet postare
Koli	40 DTS + 4,5 DTS për çdo kg

Informatat e përmendur, PK SHA, nuk do të ofrojë shërbim postar të kërkuar.

- (7) PK SHA, mund të ofrojë informata personale të shfrytëzuesve organeve kompetente dhe operatoreve tjerë postar, përfshirë administratat postare ndërkombëtare me adresën e marrësit (vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare), në përputhje me rregulloret në fuqi, për procedurat doganore, tatimore etj. Me rastin kryerjes së shërbimit postar në trafikun ndërkombëtar, PK SHA, nuk mban asnjë përgjegjësi për përpunimin e të dhënave personale në vendet e destinacionit.
- (8) Dokumentacioni në lidhje me shërbimin postar të kryer (*dokumentet postare*) ruhen për një periudhë njëzet e katër (24) muaj, dhe brenda afateve të përcaktuara me rregulloret përkatëse që rregullojnë ruajtjen e dokumentacionit manipulativ.

## X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 54

- (1) Këto Terme dhe Kushte të Përgjithshme do të vihen në dispozicion të përdoruesve në secilën zyrë postare dhe në ueb faqen zyrtare të PK SHA. [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).
- (2) Nëse një shfrytëzues i cili me PK SHA, ka kontratë dhe nuk e anulon kontratën brenda shtatë (7) ditëve nga dita e publikimit të Termeve dhe Kushteve të Përgjithshme për Shërbimet Universale, konsiderohet se i pranon këto rregulla,
- (3) Të gjitha mosmarrëveshjet dhe interpretimet në lidhje me aplikimin e këtyre Termeve dhe Kushteve të Përgjithshme për Shërbimet universale PK SHA, dhe konsumatorët do të përpiqen t'i zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellët. Nëse, në lidhje me interpretimin, ose zbatimin e këtyre Termeve dhe Kushteve të Përgjithshme, PK SHA, dhe shfrytëzuesit nuk arrijnë ti zgjidhin me marrëveshje, atëherë rastet do të ju kalojnë gjykatave kompetente.
- (4) Termat dhe Kushtet e Përgjithshme për Shërbimet Universale, hyjnë në fuqi pas shqyrtimit dhe aprovimit nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), dhe në ditën e nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i 'Postës së Kosovës' SH.A.

Prishtinë, 25.02.2021.

U.D. Kryeshefi Ekzekutiv PK, Sh.A.  
Xhevdet S. MAKIPI

